SHEJH SULEJMAN IBN NASIR EL-ULVAN

DEFINICIONI I IMANIT DHE ANULUESIT E TIJ SIPAS EHLI SUNETIT DHE XHEMATIT

Bejtul'Muhaxhirin

Nga Shejhu i shquar Sulejman ibn Nasir el-Ulvan

Definicioni i Imanit dhe Anuluesit e tij sipas Ehli Sunetit dhe Xhematit

Përktheu dhe redaktoi: Bejtul'Muhaxhirin

Pyetje: Shejhu unë Fisnik Sulejman ibn Nasir el-'Ulvan, cili është përkufizimi i imanit sipas Ehli sunetit dhe cilat janë anuluesit e tij?

Përgjigje: Ajo që është bërë e qartë nga Kur'ani dhe Suneti është, se Imani është shqiptim apo thënie dhe veprim, pra duke thënë apo shqiptuar me zemër dhe gjuhë, dhe veprimet e zemrës, gjuhës dhe gjymtyrëve, (imani) rritet dhe zvogëlohet dhe kjo është ajo që Sahabët (shokët), Tabi'inët (brezi pas sahabëve) dhe Ehli Suneti ranë dakord mbi të.

Kuptimi i "Të thuash me zemër" është besimi i tij, dhe kuptimi i "veprimeve të zemrës" është qëllimi dhe sinqeriteti i saj.

El-Imam Eshafi'i, All-llahu e mëshiroftë, ka deklaruar një ixhma (konsensus) të Sahabaëve, Tabi'inëve, dhe ata që i takuan, të cilët ishin të një mendimi se: "Imani është thënie, veprim dhe synim, dhe asnjë nga këto tre nuk mund të ekzistojë pa të tjerët". [1]

El-Imam El-Begavi, All-llahu e mëshiroftë, thotë: “Sahabët, Tabi'inët dhe ata që erdhën pas tyre nga dijetarët e Sunetit ranë dakord që veprimet e gjymtyrëve janë pjesë e Imanit. Dhe ata kanë thënë: Imani, është duke thënë apo shqiptuar, veprim dhe besim, ajo rritet me Ta'ah (bindje) dhe zvogëlohet me Ma'sijah (mosbindje). [2]

Dhe Ehli Suneti dhe Xhemati kanë rënë dakord që ai që largohet nga Xhins el-Amel është kafir. Tani çfarë nënkuptohet me Xhins el-Amel? Veprimet (fizike) të gjymtyrëve, kështu që besimi me zemër dhe shqiptimi me gjuhë nuk është i mjaftueshëm, duhet të ketë veprime me gjymtyrë.

1 Mexhmu' el-Fetava v. 7, f. 209.
2 Sherh Es-Suneh v. 1, f. 38 – 39.

El- Axhurri, All-llahu e mëshiroftë thotë: “Për më tepër, ju duhet të kuptoni se të kesh njohuri dhe besim në zemër nuk është e mjaftueshme nëse nuk shoqërohet me pohim verbal të Imanit, dhe njohuria në zemër dhe pohimi verbal nuk janë të vlefshme nëse nuk shoqërohen me veprime (fizike) të gjymtyrëve. Sapo një person të kombinojë këto tre karakteristika, atëherë ai është një Mu’min. Kjo qartësohet nga Kur'ani dhe Suneti, dhe thëniet e ulemave Muslimanë." [3]

Dhe ai (Imam El-Axhurri) gjithashtu tha se: “Veprimet (fizike) të gjymtyrëve janë dëshmi e të pasurit iman me zemër dhe gjuhë, kështu që kushdo që nuk e pohon imanin me veprimet e tij (fizike) si në Taharah (Pastrim), es-Salah (Namaz), Ez-Zekah (Zekat), Sijam (Agjërim), El-Haxh (Haxh) dhe El-Xhihad (Xhihad) dhe (vepra të ngjashme) të adhurimit, dhe është i kënaqur me veten e tij vetëm duke besuar me zemër, dhe duke shqiptuar (me gjuhë) ai nuk është një besimtar. Vetëm të besosh dhe të thuash nuk do ta ndihmoj atë, sepse braktisja e veprimeve (fizike) të gjymtyrëve është një mohim i Imanit të tij; dhe veprimi (fizik) për çështjet që përmendëm është një pohim i të pasurit Iman (besim)." [4]

Is’hak ibn Rahavej ka transmetuar një ixhma nga sahabët mbi mosbesimin e (një personi) i cili lë namazet e përcaktuara (d.m.th. Ai që nuk falet). [5]

All-llahu ﷻ thotë (kuptimi): **“...kini frikë prej Atij dhe faleni namazin e mos u bëni nga idhujtarët..”** [6]

---

3 Esh-Shari'ah v. 2, f. 686.
4 Esh-Shari'ah v. 2, f. 614.
5 Ibn Rexhebi e përmend në Fet’h El-Beri v. 1, f. 22.
6 Surja er-Rum, Ajeti 31.

Ndërsa Pejgamberi ﷺ tha: “Midis një personi dhe shirkut (politeizmit) dhe kufrit (mosbesimit) është braktisja e Namazit.” [7]

Thotë Sufjan ibn Ujejne, All-llahu e mëshiroftë: “Murxhiet e quajnë braktisjen e veprave të detyrueshme (farzeve), një mëkat i njëjtë me nivelin e kryerjes së “*El-Maherim”* (veprimeve të palejueshme), por ato nuk janë të barabarta, sepse kryerja e veprimeve të palejueshme me qëllim, ndërsa nuk i konsideron ato (Istihalal) të lejueshëm është mosbindje, ndërsa braktisja e Farzeve (veprave të detyrueshme) ndërsa personi nuk është një injorant, (për detyrën që ka për t'i kryer ato) dhe pa ndonjë justifikim, është Kufr. Dëshmi për këtë është nëse shohim rastin e Ademit dhe Iblisit, dhe Dijetarët e Xhuhdit të cilët pranonin profetësinë e Pejgamberit ﷺ me gjuhët e tyre ndërsa ata nuk vepronin sipas ligjeve dhe sheriatit të tij.” [8]

Is’hak ibn Rahavej, All-llahu e mëshiroftë, thotë: "Murxhiet vazhduan të shkonin në ekstreme, derisa nga deklaratat e tyre ishte se, "Kushdo që lë namazet e përcaktuara, agjërimin e Ramazanit, Zekatin dhe Haxhin dhe të gjitha, pra të gjitha veprat e detyrueshme, pa i refuzuar ato, ne nuk e bëjmë atë person tekfir. Llogaria e tij i lihet All-llahut pasi ai ishte nga ata që i pranonin ato (d.m.th. veprat e detyrueshme), pra, këta janë ata për të cilat nuk ka dyshim; që do të thotë janë murxhie.” [9]

El-Khalil përmendi në "Es-Suneh" se ai dëgjoi nga imam El-Humejdi Abdull-llah ibn ez-Zubejr se ai tha: "Unë u informova se ka njerëz që thonë, "Kushdo që pranon namazin dhe zekatin, agjërimin dhe haxhin, por nuk bën asnjë prej tyre derisa të vdesë,

---

7 Transmetuar nga Muslimi nën autoritetin e El-A'meshit e ky nën autoritetin e Abu Sufjanit, i cili dëgjoi i cili e dëgjoi atë nga Xhabir ibn Abdull-llahu. Gjithashtu u transmetua nga autoriteti i Ibn Xhurejxhit i cili tha se e dëgjova nga Ebu Ez-Zubejr i cili e dëgjoi atë nga Xhabir ibn Abdull-llah.
8 Fet’h El-Beri v. 1, f. 23.
9 Fet’h el-Bari v. 1, f. 21.

ose lutet i mbështetur në shpinë duke qenë në drejtimin e kundërt të Kibles, atëherë ai është Mu'min (besimtar) për sa kohë që ai nuk i refuzon (këto detyrime). 'Kështu që unë thashë,' Ky është kufër i qartë në All-llahun dhe në kundërshtim me Librin e All-llahut dhe Sunetin e Pejgamberit të Tij ﷺ dhe veprimet e Muslimanëve. [10]

Imam Ahmed ibn Hanbeli tha: “Kushdo që e thotë këtë, atëherë ai ka mohuar All-llahun dhe ka refuzuar Urdhërimet e Tij dhe Urdhrin e Pejgamberit të Tij me të cilin erdhi." [11]

Dhe kjo thënie është thënia e të gjithëve prej Ehli Sunetit dhe Xhematit. Kështu që ata të gjithë kanë rënë dakord për atë që thuhej në “*Kitab es-Sunah”* dhe Sunet (si dëshmi) që personi i cili lë veprimet (fizike) të gjymtyrëve në tërësinë e tij bëhet kafir dhe ai ka dalur nga feja Islame.

Shejhul Islam Muhamed ibn AbdulVehab, All-llahu e mëshiroftë, tha në risalen e tij të fundit *"Kashf esh-Shubuhat"*: “Nuk ka asnjë diskutim që teuhidi duhet të jetë me zemër, gjuhë dhe veprim. Nëse njëra nga këto mungon, njeriu nuk mbetet më Musliman.” [12]

Ata që kundërshtuan këtë (pikëpamje të Ehli Sunetit) ishin Gulatët (ekstremistët) Xhehmijet dhe Murxhiet, ata pretenduan se ai që largohet nga veprimet e detyrueshme nuk është aspak kafir. Dhe ne i treguam kontradiktat e kësaj deklarate me Kur’an, Sunet dhe ixhma.

Ata gjithashtu pretenduan se ai që shqipton ose thotë diçka që njihet si kufër i qartë atëherë ky person nuk bëhet kafir derisa të

10 Sherh Es-Suneh v. 3, f. 586.
11 El-Lelika'i në Sherh usul el-i'tikad v. 5, f. 887.
12 Kashf as-Shubuhat v. 6, f. 131.

bëjë xhuhd (mohon) ose istihlal (e bën atë hallall). Kjo thënie dhe kuptimi i saj është batil (i kotë) dhe nuk ka asgjë nga gjurmët e dijes Islame në të.

Kriteret e diçkaje që është kufër janë të thjeshta, thëniet që ata kanë shqiptuar, All-llahu ﷻ tha (kuptimi): **"Ata betohen në All-llahun se nuk kanë thënë (asgjë të keqe), e në të vërtetë kanë thënë fjalë që nuk përkojnë me besimin, dhe pasi patën shprehur besimin ata e mohuan."** [13]

Dhe në Kur'an dhe Sunet, në të dyja janë dëshmitë e gënjeshtrës së kësaj deklarate dhe kuptimit të saj, ku All-llahu ﷻ thotë (kuptimi): "E nëse i pyet ti ata (përse tallen), do të thonë: **"Ne vetëm jemi mahnitur e dëfryer". Thuaj: "A me All-llahun, librin dhe të dërguarin e Tij talleni?" "Mos kërkoni fare ndjesë, ju pasi që (shpallët se) besuat, keni mohuar."** [14]

Ulematë (dijetarët) kanë rënë dakord se ai që fyen Pejgamberin ﷺ është një kafir pa e kufizuar atë në urrejtjen ndaj tij ﷺ, ose kufizimin e tij në istihlal (duke e parë atë të lejueshme, d.m.th. për ta fyer atë).

Gjithashtu dijetarët kanë rënë dakord që bërja Sexhde një Sanami (idhulli) ose bërja e tavafit rreth varreve, është kufër pa e kufizuar atë me istihlal (duke e parë atë si të lejuar).

Poashtu ata (dijetarët) kanë rënë dakord që hedhja e Mus'hafit (Kur'anit) në kosh ose në një vend të ndyrë është vepër kufri pa e kufizuar atë me istihlal (duke e parë atë si të lejuar).

13 Surja Teube, Ajeti 74.
14 Surja Teube, Ajetet 65 – 66.

Dhe nga të gjithë këto shfuqizues, usule (parime) të Xhehmijve dhe dhe Murxhieve, kjo i bën të pavlefshme thëniet e tyre në çështjet e imanit.

Në pyetjen e bërë nga vëllai, ai dëshironte të dinte navakid'h (anuluesit) e Aslu Dinit ose atë që ne e quajmë Iman. Prej tyre ka shumë dhe ne tashmë kemi përmendur disa e ata janë:

● Lënia e veprave të detyrueshme.
● Lënia e namazit në tërësinë e tij.
● Të bësh tavaf rreth varreve dhe sexhde Sanam (idhullit).
● Hedhja e Kur'anit në vende të ndyra.
● Lutja ndaj dikujt tjerët përveç All-llahut ﷻ.
● Afrimi duke therur (flijuar) për dikë tjetër përveç All-llahut.
● Bërja e (zotimit) për evlijatë.
● Fyerja e All-llahut dhe Pejgamberit të Tij.
● Tallja me Dinin.
● Zëvendësimi i sheriatit me kanune (ligje) të bëra nga njeriu dhe vendosja e tyre në të njëjtin nivel me Hukmin e All-llahut dhe Resulit të Tij. All-llahu ﷻ ka thënë (kuptimi): **"E kush nuk gjykon sipas asaj që ka shpallur All-llahu - atëherë ata janë jobesimtarë."** [15] Pra, kriter për kufër në këtë ajet është lënia e Hukmit të All-llahut dhe largimi prej tij. Arsyeja perse All-llahu ﷻ e zbriti këtë ajet është për atë i cili gjykon me kufër, për atë që largohet nga Hukmi i All-llahut dhe largohet prej tij (duke përdorur) ligjet e njerëzve.

Kur kufri (i fjalës) paraprihet me 'Elif dhe Lam' atëherë ai është gjithmonë kufër i madh.

Dhe ajo që transmetohet nga Ibn Abasi se ai tha: "Është kufr dune kufr (mosbesimi më pak se mosbesimi)" nuk është autentik prej

15 Surja Maide, Ajeti 44.

tij dhe unë kam treguar dobësinë e tij në shumë thënie dhe shkrime të tjera.

Abdullah ibn Mesudi, All-llahu qoftë i kënaqur me të, u pyet për ar-Rishvah (ryshfetin), kështu që ai tha: Është nga es-Suht (diçka e paligjshme) kështu që iu tha: "Po sikur të jetë në Gjykim?" Kështu që ai tha: “Kjo është kufr.” Ky ether është sahih (i vërtetë) i transmetuar nga Ibn Xheriri në tefsirin e tij dhe gjithashtu nga Ebu Jala në Musnedin e tij si dhe nga Vaki në “*Akbar El-Kudah”.*

Kështu kushdo që sundon me kanune (ligje) të bëra nga njeriu, ose me legjislacionin e xhahiljetit dhe i zbaton ato si kanune (ligje), ose ka një pjesë prej këtyre legjislacioneve, dhe atë e imponon mbi njerëzit, dhe i detyron ata që t'i përmbahen atyre dhe të kërkojnë gjykim në bazë të tyre dhe largohet nga sheriati i All-llahut ose nënçmon ata që duan të zbatojnë Kitabin (Kur’anin) dhe Sunetin, atëherë ai është një kafir në All-llahun e Madhërishëm.

Dhe cili kufër është më i madh sesa largimi nga sheriati i All-llahut duke e penguar dhe parandaluar atë dhe ndjekur penalisht ata që thërrasin në të duke i etiketuar ata si njerëz me ide të prapambetura që nuk janë të përshtatshme për këtë civilizim aktual?!

Nga hipokrizia kryesore në të cilën po mbyten këta ligjvënës është se nëse ata thirren për zbatim të Hukmit të All-llahut dhe Resulit të Tij ﷺ ata largohen prej tij, duke i penguar njerëzit prej tij, duke vepruar me arrogancë (të madhe). Njëri prej tyre deklaroi: “Hukmi i All-llahut nuk është i përshtatshëm për kohën dhe epokën tonë moderne, sepse ne po jetojmë në një epokë zhvillimi, civilizimi dhe po përpiqemi të ecim me vendet

Evropiane. Zbatimi i sheriatit do të na çojë drejt kthimit dhe nënzhvillimit.” dhe kjo është thënia dhe gjendja e të gjithë atyre të cilët zbatojnë kanunet (ligjet) e bëra nga njeriu edhe nëse nuk i thonë ato fjalë në publik. Veprimet e tyre fizike janë dëshmi e zemrave dhe e thënieve të tyre.

Unë me këtë nuk dua të them faktin se ata janë duke luftuar ata që përpiqen t'i japin atyre këshilla, ose duke i dhënë krijesave të drejtën për vendosjen e ligjeve deri në pikën që Vendimet e Sheriatit të paraqiten në parlament dhe çfarëdo miratimi që bëjnë ata të bëhet pjesë e sistemit dhe ajo që nuk miratohet bëhet e ndaluar. Ky sistem është një sulm i madh ndaj Legjislacionit Hyjnor dhe shkelje kundër Vendimeve të qarta. Pa dyshim që shpallja e ligjeve të tilla është në konkurrencë me All-llahun në Sundimin, Urtësinë dhe Hyjninë e tij.

Kufizimi i kufrit (mosbesimit) në (një person) që bën xhuhd (mohim) ose istihlal (bërjen hallall), nuk ka asl (rrënjë) sepse istihlali dhe xhudi janë dy realitete të ndryshme të kufrit edhe nëse është jo e kombinuar me zbatimin e bërë nga kanunet (ligjet) e njeriut.

Shejhul-Islam ibn Tejmije All-llahu e mëshiroftë, ka thënë: "Kurdoherë që një person bën hallall atë që është haram nga ixhmaja ose e bën haram atë që është hallall nga ixhmaja ose zëvendëson sheriatin për të cilin është rënë dakord nga ixhmaja, atëherë ai është një kafir me konsensusin e dijetarëve të Fikhut." [16]

Ndërsa Ibn Kathiri, All-llahu e mëshiroftë, tha: "Kushdo që braktis sheriatin që i’u shpall Muhamed ibn Abdull-llahut ﷺ, vulës së Pejgamberëve, dhe i referohet për legjislacion dhe

16 Mexhmu El-Fetava, v. 3, f. 267.

gjykim ndonjë ligji tjetër që është shfuqizuar sikurse (Inxhilit apo Tevratit) ka kryer një veprim të kufrit, kështu që, si është çështja e atij që i referohet për gjykim dhe legjislacion (ligjeve të Tatarëve) dhe i jep përparësi atyre përpara (sheriatit)? Ai që e bën atë është një kafir me ixhma të të të gjithë Muslimanëve." [17]

Thotë All-llahu ﷻ (kuptimi): **"Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty as të asaj para teje) derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht."** [18]

Dhe thotë Ai ﷻ (kuptimi): **"A i vure re ata që mendojnë se besuan atë që të zbriti ty, dhe atë që zbriti para teje, se si dëshirojnë që mes tyre të gjykojë taguti, e duke qenë se janë të urdhëruar që të mos e besojnë atë. E djalli dëshiron t'i humbë në pafundësi."** [19]

Dhe kur thuhet: Sundimtari i cili nuk sundon me atë që është shpallur nga All-llahu, edhe pse nuk e preferon atë kanun (ligj) përpara Hukmit të All-llahut atëherë ai beson në gënjeshtrën e tij.

Atëherë ne themi: Kjo nuk është asgjë, dhe ky justifikim nuk e ndryshon Hukmin e All-llahut mbi të, sepse ai që adhuron një idhull është një mushrik apo felëshues jashtë fesë Islame edhe nëse ai pretendon se shirku është shoqërim ndaj All-llahut, dhe ai e bëri atë për shkak të disa përfitimeve të kësaj bote. Thotë All-llahu ﷻ (kuptimi): **"...Në vendimin e Tij nuk mund t'i përzihet askush."** [20]

17 El-Bidaje vel Nihaje, v. 13, f. 118 – 119.
18 Surja Nisa, Ajeti 65.
19 Surja Nisa, Ajeti 60.
20 Surja Kehf, Ajeti 26.

Kur bëhet fjalë për kërkimin e justifikimeve për ata ligjvënës që u larguan nga Dini pavarësisht se ata shqiptonin Shehadetin se *"La ilahe il-laAll-llah, ue ene Muhameden Resul All-llah"*.

Ne u themi si vijon:

1. Munafikët të cilët do të qëndrojnë në thellësitë e Zjarrit të Xhehenemit ata e shqiptuan shehadetin, u falën, agjëruan dhe kryen Haxhin dhe kjo nuk do t'u sjellë dobi atyre.

2. Ata që bënë tavaf rreth kubur (varreve), duke u lutur atyre dhe duke u ofruar atyre flijime, edhe ata gjithashtu shqiptuan shehadetin dhe All-llahu ﷻ për ta tha (kuptimi): **"… Ai që i përshkruan Zotit shok, All-llahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) atij xhenetin dhe vendi i tij është zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës."** [21]

3. Ose ata të cilët thanë: "Ne kurrë nuk kemi parë dikë si njerëzit tanë të cilët janë të përmendur në Kur'an kur bëhet fjalë për të ngrënë më shumë ose për të thënë më shumë gënjeshtra ose për të qenë më frikacak kur takoheni me armikun" e me këtë ata synonin Pejgamberin e All-llahut ﷺ dhe Sahabët e tij kështu që Kur'ani zbuloi kufrin e tyre në suren Teube Ajetet 64 - 66. Edhe ata e shqiptuan shehadetin, e kryen namazin, agjëruan dhe kryen Xhihad fisebililah (në rrugë të All-llahut).

4. Rafidit (Shiat) ata që fyejnë dhe shpifin për sahabët, dhe pretendojnë dhe besojnë se Ebu Bekri, Umeri dhe Uthmani, All-llahu qoftë i kënaqur me ta, janë kufar, këta (Rafidit) të cilët shpifin për Nënën e Besimtarëve Aishen, All-llahu qoftë i kënaqur me të, këta poashtu shqiptojnë shehadetin.

21 Surja Maide, Ajeti 72.

5. Sehirbazët, magjistarët, priftërinjtë, astrologët gjithashtu shqiptojnë shehadetin.

6. Bijtë e Mejman el-Kadah gjithashtu shqiptojnë shehadetin, ata falnin namazin dhe ndërtonin Xhamija, pavarësisht se Umeti ishte pajtuar për kufrin e tyre.
Kjo është diçka e njohur në mesin e studentëve të rinj të dijes, për të mos përmendur studentët e avancuar të dijes, dhe njerëzit e dijes kanë shkruar shumë libra për braktisjen dhe (shfuqizuesit) e Islamit të cilat ju mund t'i rishikoni.

Ehlul-Ilmi dhe Suneti bëjnë dallimin midis një mëkati që bie në kundërshtim me Asl-in e Imanit dhe midis një mëkati që e anulon atë, kështu që ata nuk bëjnë tekfir bazuar në çdo mëkat. Njerëzit e dijes kanë rënë dakord që ai që bën një mëkat të madh të mos bëhet tekfir, për sa kohë që ai nuk e bën atë të lejueshëm, kështu që një Musliman nuk bëhet një kafir kur bën zina, pi alkol ose tregton me riba (interes) sepse këto harame nuk e anulojnë Aslin e Imanit. Të flasësh për këtë kërkon më shumë kohë, dhe unë tanimë kam folur për këtë çështje edhe në shumë vende të tjera dhe e shpjegova çështjen e një personi i cili lë veprimet e detyrueshme (fizike) me gjymtyrët dhe riden (felëshimin) e atyre që zëvendësuan sheriatin e All-llahut dhe ata që u larguan nga ajo që i’u shpall Pejgamberit ﷺ.

Sidoqoftë dua të shtoj dhe them se, të flasësh për këtë çështje dhe të tjera që kanë të bëjnë me navakidh (anuluesit) është të flasësh për (rregullin) e përgjithshëm dhe jo për (vendimin) individual. Kjo do të thotë se ai që shqipton një fjalë të kufrit, ose bën një veprim të kufrit, dhe njihet si kufër i prerë apo i qartë, atëherë ai ka bërë kufër.

Kur bëhet fjalë për bërjen tekfir të (individit) ju duhet të bëni ikamet Huxha (të sillni prova) kundër tij dhe të hiqni të gjitha shubuhatet (dyshimet) sikurse Xhehli (injoranca) dhe se ai nuk po ndjek një Te'vil Sa'igh (keqinterpretim i besueshëm) dhe se ai nuk është Mukrah (i detyruar). Pra, kur provat të vendosen kundër tij dhe të gjitha barrierat e tekfirit janë hequr, ai bëhet një murted (felëshues) nga Dini i Islamit dhe bëhet një detyrim për sundimtarin Musliman që të zbatojë Hukmin e All-llahut mbi të.
Njerëzit duhet të qëndrojnë larg zbatimit të Vendimeve të Hududit dhe rregullave të All-llahut mbi individ pa Sulltan, sepse kjo do të çojë në kaos në shoqëri dhe nuk do të arrihet meselja e kërkuar. Ndërsa rreth kësaj ka shumë për të thënë, mirëpo unë mund ta bëj këtë në një takim tjetër.

Unë do të tregoj disa arsye prapa devijimit në këtë çështje dhe gabimet në fjalimet e shumë dijetarëve bashkëkohorë. Ka dy sekte që devijuan në këtë çështje madhore:

● Havarixhët. Ata i kanë vendosur mëkatarët nga radhët e monoteistëve, jashtë shtresës së Islamit, ata i kanë klasifikuar gjërat si mëkate që nuk janë mëkate, dhe ata kanë vendosur vendimet e Kufrit në bazë të kësaj, dhe ata nuk i morën parasysh rregullat Sheriatike, as Mutllakin ose Mukajadin dhe as pengesat që parandalojnë tekfirin.

● Murxhiet. Këta i kanë takuar ata në të njëjtën mashtrim; sepse ata pretenduan se askush nuk mund të bëhet kafir me një mëkat, çfarëdo qoftë ai mëkat (pra as për mëkatin e kufrit), derisa ai ta bëjë atë të lejueshëm ose ta mohojë atë.

Kur'ani, Suneti dhe ixhmaja kanë deklaruar prishjen e këtyre dy medh'hebeve dhe devijimin e këtyre dy grupeve.

Unë do të doja të përfundoja duke theksuar një çështje të rëndësishme që është; Jo të gjithë që i ngjajnë Murxhi’eve në të folur bëhen Murxhi dhe jo çdo person që thotë diçka që konsiderohet nga mendimet e Havarixhëve mund të etiketohet si Havarixh. Vendimi (mbi një person) me Irxha absolute ose se ai është nga Havarixhët mund të bëhet vetëm nëse ai i përmbahet usuleve (parimeve) të tyre të zakonshme.
Mund të thuash për një njeri: "Ai ka ca Irxha kur bëhet fjalë për një çështje specifike" ose "Ai ka disa nga medh’hebi i havarixhëve".

Dhe kini kujdes nga Dhulmi (shtypja) dhe Baghi (shkelja) kur flisni për të tjerët nga ‘Ulemat, Du’at (thirrësat e Islamit), Muslihinët (reformatorët) dhe të ngjashmit e tyre. Sepse drejtësia në të thënë dhe në veprime është karakteristikë e besimtarit dhe është diçka që All-llahu e do dhe e urdhëron si në thënien e Tij ﷻ (kuptimi): **“...Kur të flitni (të dëshmoni), duhet të jeni të drejtë.”** [22] Dhe Ai ﷻ gjithashtu thotë (kuptimi): **“All-llahu urdhëron drejtësi, bamirësi…”** [23]
I gjithë njerëzimi, qoftë Mu’min ose kafir, njerëz apo xhin ka rënë dakord për dashurinë që kanë për drejtësinë dhe i gjithë njerëzimi ka rënë dakord për urrejtjen e tyre ndaj shtypjes, duke urrejtur njerëzit e saj dhe duke i mallkuar ata. Pavarësisht se sa lartë ka arritur niveli i devijimit apo devijimeve, të kundërshtarit tuaj, kjo nuk e justifikon shtypjen dhe gënjeshtrën për të. Bëhuni nga më të mirët në mesin e njerëzve dhe për të tjerët flisni vetëm me dituri dhe drejtësi. Dhe bëjeni qëllimin tuaj të mbështesni Hak-un dhe të jeni një këshilltar i sinqertë për të tjerët. Sepse Pejgamberi ﷺ tha: *"Kush beson në All-llahun dhe në Ditën e Fundit duhet të flas atë që është e mirë ose të heshtë"*. [24]

22 Surja Enam, Ajeti 152.
23 Surja Nahl, Ajeti 90.
24 Dhe mbi vërtetësin e hadithit nën autoritetin e Ebu Hurejrës, All-llahu qoftë i kënaqur me të.

Bejtul'Muhaxhirin